



VENDIM

Nr. 23, Datë 13/07/2017

Për miratimin e "Planit të zhvillimit strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2020"

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 13/07/2017, në zbatim të nenit 38 (Funksionet e Senatit Akademik) të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pasi shqyrtoi Relacionin e Rektorit të UART, Prof. Kastriot Çausi, Për miratimin e "Planit të zhvillimit strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2020", dhe pasi e diskutoi:

VENDOSI

1. Miratimin e "Planit të zhvillimit strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2020".
2. Bashkëlidhur, dokumenti i "Planit të zhvillimit strategjik të Universitetit të Arteve për vitet akademike 2018-2020".

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA



Universiteti i Arteve

PLANI STRATEGJIK

I

UNIVERSITETIT TË ARTEVE TIRANË

(2018-2020)

Kjo strategji është përgatitur nga grupi i punës i përbërë si më poshtë:

1. Prof.Kastriot ÇAUSHI,
2. Prof.Petrit MALAJ
3. Prof.Asoc.Ardjan ISUFI,
4. Prof.Dr. Isak SHEHU,
5. Alma SINANAJ
6. Prof.Dr. Erald BAKALLI,
7. Prof. Asoc. Dr. Elida RAPTI,
8. Prof. Milto KUTALI
9. Prof. Ilir MARTINI,
- 10.Prof. Arben LLOZI,
- 11.Prof.Asoc.Kastriot TUSHA,
- 12.Prof.Asoc.Dorian CENE
- 13.Msc. Elia ADEMI/PLAKU,
- 14.Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI,
- 15.Prof.Asoc. Albes FUSHA,
- 16.Prof.Asoc.Pjerin KOLNIKAJ
- 17.Adriatik KRAJA

1. VIZIONI DHE MISIONI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE TË TIRANËS 2018-2020

Strategjia përfshin:

- 1 Studentët politika e përzgjedhjes dhe inkurajimit të talenteve;
- 2 Programet, kurrikulat;
- 3 Stafin akademik-formimi dhe reformimi

Misioni:

Universiteti i Arteve ka për mision edukimin profesional artistik, realizimin e projekteve artistike dhe shkencore në fushën e muzikës, artit skenik, artit figurativ dhe të aplikuar. Misioni i saj lidhet me formimin artistik duke u mbështetur fort në ruajtjen e traditës së mëparshme si dhe garantimin e nivelit të lartë dhe cilësor në të gjitha fushat ku ky institucion operon.

Vizioni:

Universiteti i Arteve synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit, dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së artit. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin dhe projektet artistike, ajo kërkon të përgatisë jo vetëm artistë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Plotësimi i studimeve në vazhdimësi duke e bërë të mundur për ta, të tre ciklet e formimit universitar. Universiteti i Arteve duhet ta shohë edhe më tej vetveten në kuadrin e një perspektive të gjerë ndërkombëtare duke shpalosur individualitetin e vet në gjuhë dhe kulturë.

1.1. Vizioni ynë strategjik

Universiteti i Arteve do të përballet me sfida gjithnjë e më të mëdha nga vetë studentët, punëdhënësit dhe shoqëria. Vizioni ynë strategjik është integrimi de jure rajonal, evropian dhe global, duke çuar më tej atë traditë që de facto e bën Universitetin e Arteve një nga IAL-të shqiptare konkurrencte me produktin e saj në tregun evropian dhe botëror.

Universiteti i Arteve do të mbështetet gjithnjë e më tepër në tre boshte kryesore të cilët janë:

- Edukimi,
- Krijimtaria artistike dhe kërkimi shkencor,
- Produksioni artistik dhe menaxhimi i tij.

Universiteti i Arteve operon në një treg global, duke konkurruar brenda vetes dhe brenda vendit për t'i shërbyer atyre që duan të shkollohen në Shqipëri si dhe duke plotësuar të gjitha nevojat e tregut të shkollimit artistik me afrimin e politikave konkurruese me tregun vendas dhe me atë të huaj. Universiteti i Arteve do të punojë për të ndërtuar dhe zgjeruar edhe më tej fushën e veprimtarisë së saj, në mënyrë që të ofrojë mundësinë e zgjedhjes për të gjithë ata që kanë talentin dhe dëshirën për të studiuar dhe thelluar studimet në fushën e artit.

1.2. Roli ynë

Aktiviteti i Universitetit të Arteve përfshihet sot por edhe në të ardhmen, brenda një hapësire me tre fusha kryesore, që përfshijnë:





- Edukimin dhe kualifikimin artistik (të studentëve, mësuesve të shkollave të artit, dhe të gjithë atyre që operojnë në këtë fushë)
- Promovimin e vlerave artistike (aktivitete kulturore dhe artistike si dhe botime për të nxjerrë në pah dhe orientuar tregun drejt vlerave njerëzore dhe produktit të tyre).
- Rritjen e aftësisë për menaxhim më të mirë të karrierës dhe orientimin drejt kërkesave të tregut.

Universiteti i Arteve është i fokusuar në këto problematika të rëndësishme:

Si bazë kryesore e zhvillimit të fokusin tonë do të jetë ruajtja dhe rritja e mëtejshme e cilësisë në mësimdhënie. Në këtë pikë një rëndësi të madhe luan rritja e nivelit profesional dhe artistik i personelit akademik. Stafit akademik nëpërmjet bashkëpunimeve si brenda dhe jashtë vendit, do të përcillte eksperiencat më të mira të vendeve të rajonit nga shkollat e tjera të artit. Kualifikimi i tyre akademik dhe artistik do të krijojë gjithmonë trendin më të mirë të ngritjes profesionale artistike si dhe ta pasurimit kurikular.

Duke u mbështetur në traditën e mirë tashmë të krijuar nga stafi akademik në përfshirjen e tyre në aktivitete artistike në kalendarët jo vetëm kombëtar por dhe ndërkombëtar, do të arrihet performanca e kërkuar në auditorët e UA. Raporti i kualifikimit të stafit akademik, eksperiencia e tyre e fituar nga bashkëpunimet e ndryshme do të ndërthurte më së miri edhe punën e zbatimit praktik në ambiente laboratorike bashkëkohore për një cilësi dhe arritje artistike më të mirë të studentëve. Për këtë pikë një rëndësi të veçantë zë edhe ndërtimi i laboratorëve bashkëkohore në atelie, studio, salla për të tre fakultetet sipas specifikave për program studimi.

Njëkohësisht do të kërkohet:

- Vendosja e një rrjeti bashkëkohor të informacionit dhe digjitalizimin e administratës;
- Përfundimin e projektit të plotë për digjitalizimin e bibliotekës së UA;
- Zhvillimin e mëtejshëm të studimit dhe kritikës së artit;
- Përshtatje e mëtejshme me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit dhe plotësimit të tyre ekzistuese sipas kërkesave të akteve ligjore në fuqi;
- Studimin e kërkesave të tregut për produktin që del nga UA, duke e intensifikuar kërkimin për produktin.
- Përmes kërkesës së mbështetjes me fonde nga qeveria dhe partnerë të tjerë ne do të ndihmojmë ngritjen e një sistemi ku të rritet ekselenca në mësim dhe transferimi i njohurive.

Një nga objektivat tona është puna në grup, prandaj ne dëshirojmë të punojmë në mbështetje të:

- Qëllimeve dhe prioriteteve kombëtare;
- Qëllimeve individuale dhe misioneve si një trup autonom;
- Interesit të shpërndarjes së eksperiencës.



2. PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE 2018-2020


Në zhvillimin e planit strategjik synojmë të tregojmë rrugën përmes të cilës do të kalojë reforma universitare në Universitetin e Arteve.

Plani i zhvillimit strategjik synon ta transformojë Universitetin e Arteve në një komunitet të fortë, autonom dhe të integruar të studentëve, të profesorëve, të artistëve dhe kërkuesve të rinj.

Universiteti i Arteve duhet të vazhdojë të jetë promotori kryesor i mësimit gjatë gjithë jetës, të jetë tërheqës dhe konkurrues në tregun kombëtar dhe rajonal, përmes sigurimit të programeve në Bachelor, Master si dhe hapjes së ciklit të tretë të studimeve në Doktoraturë, në përputhje me zhvillimet më të fundit evropiane dhe botërore si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky plan mbulon periudhën Janar 2018 - Korrik 2021. Të gjitha veprimet e propozuara në këtë plan lidhen me këtë periudhë.

2.1. Qëllimet strategjike të UNIVERSITETIT I ARTEVE



Qëllimi i planit strategjik:

Të arrihet një rezultat maksimalisht cilësor, drejt të cilit ne jemi duke punuar përtej kohëzgjatjes së këtij plani strategjik.

Objektivat:

Largpamësia dhe mjetet me të cilat do të punojmë drejt realizimit të qëllimit.

Në Universitetin e Arteve reforma e kurrikulave po realizohet duke pasur parasysh një sërë kërkesash, të shtruara tashmë para shkollës, të cilat i dikton e tashmja dhe e ardhmja e fushës ku veprojmë dhe tregut artistik shqiptar, evropian dhe më gjerë. Pjesë e kësaj reforme është edhe përfshirja e diplomave që lëshon UA në profesionet e rregulluara, tashmë si një nevojë e përfshirjes së akteve ligjore për tregun e punës. Objektivat e veprimtarisë sonë në fushën e reformës së kurrikulave, ndër të tjera synojnë që kurrikulat:

- Të vazhdojnë të jenë konkurruese në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të pajisin studentët me dijet dhe aftësitë e duhura për fushën që ato studiojnë.
- Të mundësojnë që studentët të jenë më konkurrues në tregun e punës pas diplomimit të tyre;
- Të ofrojnë fleksibilitet të mjaftueshëm për zhvillime në të ardhmen dhe për të bërë përshtatje në përputhje me ndryshimin e kushteve;
- T'u mundësojnë studentëve vazhdimësi studimi gjatë gjithë jetës;
- Të sigurojnë raporte të drejta në mes formimit teorik dhe praktik të studentëve;



- Të mundësojnë aktivitete plotësuese që janë të nevojshme për përvetësimin sa më të mirë të programeve mësimore;
- Të jenë tërheqëse për një numër sa më të madh studentësh;
- Të jenë të përballueshme nga stafi akademik;
- Të orientojnë disponimin e resurseve të nevojshme për zbatimin e tyre.

Përmes kësaj reforme ne synojmë që të eliminojmë dobësitë që ekzistojnë tashmë dhe do të mundësojmë:

- Vazhdimësi të studimeve në nivel universitar dhe pasuniversitar;
- Nivel më të lartë në drejtim të formimit profesional artistik të studentëve;
- Përshtatje me kërkesat dhe mundësitë e tregut të punës për profesionet që ofron Universiteti i Arteve;
- Më shumë nxitje për mobilitete (për studentët dhe për stafin akademik);
- Nxitje e bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë,
- Zhvillimin e kurrikulave në vazhdimësi,
- Bashkëpunim ndërinstitucional si brenda dhe jashtë vendit,
- Programe të integruara studimi,
- Trajnimi dhe kërkimi i stafit akademik.

Për të mundësuar kurorëzimin me sukses të kësaj reforme, përmirësimin e kurrikulave dhe modularizimin e studimeve, ne kemi vlerësuar se duhen zgjidhur hap pas hapi një sërë problemesh të tilla si:

- Njohja në detaje se çfarë figure specialisti duhet të përgatitet;
- Njohja me tregut e punës,
- Vlerësimi se cilat do të jenë alternativat e mundshme të punësimit të diplomuarave në Universitetin e Arteve;
- Konceptimi i moduleve dhe i ngarkesave të studentëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Analiza dhe rivlerësimi i punës së bërë për vit akademik,
- Ballafaqimin e konkluzioneve të arritura me studentët,
- Institucionet dhe aktorët e tregut të punës.



3. ANALIZA SWOT NË NDIHMË TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Plani strategjik i Universitetit të Arteve mund të hartohet drejt në se bëhet një analizë e hollësishme SWOT, e cila merr në konsideratë faktorët e brendshëm si dhe faktorët e jashtëm, për një koherencë të problemeve dhe faktorizimin e mirë të tyre për secilin sektor apo nivel kategorie.

3.1. Faktorët e brendshëm (pikat e forta dhe të dobëta)

Pikat e forta:

- Trashëgimia akademike dhe tradita e gjatë afro 60 vjeçare në mësimdhënie në lidhje me përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e artit.
- Rezultate të larta dhe të njohura të diplomuarve në këtë institucion, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.
- Autoriteti dhe reputacioni i fituar i këtij Universiteti në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Institucion unikal në vend (pavarësisht përpjekjeve sporadike të IAL-ve private të cilat nuk kanë shumicën e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Arteve)
- Potencial i lartë intelektual dhe artistik i stafit akademik.
- Përfshirja e 32 programeve të studimit në ciklin e parë me kohë të plotë Bachelor si dhe 32 programeve të studimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master.
- Përthithjen e nivelit më të mirë të konkurrentëve si student në UA nga Shqipëria dhe trevat shqipfolëse, sipas kriterëve konkurruese.

Pikat e dobëta:

- Institucion relativisht i vogël për nga numri i studentëve për shkak të specifikës.
- Mospërshtatja në disa raste e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, me specifikën e veçantë në Universitetin e Arteve në:
 - Në mbështetjen financiare;
 - Në mbështetjen e një infrastrukturë fizike dhe laboratorike;
 - Kategorizimin dhe kualifikimin e personelit akademik.
- Vendosja e raporteve më të ngushta me institucionet e arsimit të mesëm artistik dhe të arsimit përgjithshëm, për përthithjen e talentëve në Republikën e Shqipërisë;
- Pamundësia e informacionit nga institucionet qendrore dhe lokale mbi alumin si dhe kërkesat e tregut për profesionet që ofron UA.

3.2. Faktorët e jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet)

Mundësitë:

- Arti dhe kultura janë dhe do të mbeten edhe më tej sektori më përfaqësues cilësor i vendit tonë në arenën evropiane dhe botërore, duke qenë më i përgatitur dhe afër tregut ndërkombëtar të punës me produktet e tij dhe burimet njerëzore falë edhe punës dhe kontributit të Universitetit të Arteve.
- Politika kombëtare të favorshme në lidhje me reformimin.
- Marrja në konsideratë e rolit këshillues të Universitetit të Arteve në politikat qeveritare për reformimin e institucioneve të arsimit të mesëm dhe institucioneve artistike.



- Atraktiviteti, përshtatja dhe shtimi i programeve mësimore për rritjen e interesit dhe dëshirës për shkollim në fushën e artit.
- Politika mbështetëse të qeverisë dhe organizmave ndërkombëtare për përfshirjen e stafëve akademike në problematika me interes në fushën e artit.
- Vendosja e marrëdhënieve institucionale me institucione të fushës së artit.

Kërcënimet:

- Mungesa e strategjive të mirëfillta të zhvillimit të shtetit për artin dhe kulturën.
- Legjislacion jo gjithnjë në përputhje dhe/ose pjesërisht i papërshtatshëm për specifikën e veçantë të Universitetit të Arteve.
- Mungesa e kuptimit të problemeve madhore të artit dhe kulturës nga politik bërësit.
- Adaptimi i eksperiencave të huaja të papërshtatshme për kushtet konkrete.
- Kontingjente të dobëta studentësh që vijnë nga arsimi i mesëm.
- Taksë e ulët shkollimi, e cila nuk mbështet zhvillimin perspektiv të Universitetit të Arteve.
- Infrastrukturë e dobët.
- Domosdoshmëria e një numri të madh të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar për realizimin e procesit mësimor si pasojë e specifikës së Universitetit

Synimet:

- Zhvillimi fizik i Universitetit të Arteve në kufij të pranueshëm me ndihmën e qeverisë dhe projekteve të tjera.
- Balancim i aktiviteteve mësimore me ato artistike dhe kërkimore.
- Zhvillimi i mësimit gjatë gjithë jetës.
- Hartimi dhe adaptimi i kurrikulave të reja fleksibile, në përputhje me tendencat dhe eksperiencat kombëtare dhe evropiane.
- Zhvillimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.
- Politika më të mira rekrutimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore në Universitetin e Arteve.
- Integrimi dhe përsosja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat jo qeveritare dhe institucionet e tjera të fushës së artit.
- Kompletimi me infrastrukturë moderne në përshtatje me specifikën e UA. Ndërtimi i një infrastrukture informatike e digjitale në dobi të procesit krijues e shkencor e po ashtu të studenteve, pedagogëve dhe administratës.
- Integrim më i mirë i mësimit me projektet artistike dhe kërkimin.
- Atashimi i institucioneve kërkimore-shkencore të fushës artit dhe trashëgimisë kulturore pranë Universitetit të Arteve.
- Mbështetje më aktive e stafit akademik të Universitetit të Arteve për realizimin e projekteve kërkimore dhe artistike në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Transformimi i Universitetit të Arteve në një nga pikat e referimit për të gjitha politikat kombëtare të zhvillimit të artit.
- Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik.
- Menaxhim efikas i burimeve financiare dhe materiale me synimin mbështetje të njëjësive akademike që demonstronjë përkushtim në mësimdhënie, kërkim dhe realizime artistike.
- Forcimi dhe zgjerimi i kooperimit me universitetet e huaja në drejtim të:
 - i. shkëmbimit të eksperiencës ;





- ii. mobiliteteve të stafit akademik, jo akademik dhe studentëve;
- iii. projekteve artistike dhe kërkimore të përbashkëta;
- iv. botimeve të përbashkëta.

Realizimi i synimeve të përcaktuara më sipër, kërkon si domosdoshmëri ndjekjen në vazhdimësi të hapave për informimin dhe përfshirjen e të gjithë stafit akademik në procesin e reformimit të Universitetit të Arteve duke i konsideruar idetë, sugjerimet dhe opinionet e tyre, duke vendosur prioritete për ndryshime në nivel të institucionit dhe çdo njësie akademike dhe duke krijuar një plan veprimi operativ me afate të përcaktuara.

4. EDUKIMI NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Edukimi në Universitetin e Arteve përmbush këto detyrime:

- Përmirësimin e programeve të studimit;
- Forcimin e orientimit drejt studentëve dhe tregut;
- Zgjerimin e edukimit drejt specializimeve të gjera dhe zhvillimi i formave të reja të edukimit;
- Sigurimin e infrastrukturës së mësimin dhe asaj organizative;
- Forcimin e kompetencave akademike, profesionale, sociale dhe etike të edukimit.

Edukimi në Universitetin e Arteve është i organizuar në dy nivele shkollimi:

- Cikli i parë i studimeve Bachelor;
 - Cikli i dytë i studimeve "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/ "Master i Arteve";
 - Po punohet për hapjen e ciklit të tretë të studimeve në Doktoraturë, dhe jemi në pritje të daljes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të arsimit dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë Nr.80/2015.
1. Kurikula në ciklin e parë të studimeve Bachelor zgjat jo më pak se tre vjet dhe në përfundim mbyllet me 180 ECT. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë është tre vite dhe për të fituar një diplomë studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Në përfundim të studimeve në të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Universiteti i Arteve, studenti duhet të grumbullojë të paktën sasinë e krediteve të përcaktuara më sipër. Studenti mund të përfundojë kursin e studimeve, të mbrojë punimin e diplomës brenda afateve të përcaktuara në programet e studimit apo përtej këtyre afateve në përputhje me përcaktimet me rregulloren në fuqi të miratuar nga Senati Akademik, si dhe akteve Ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky cikël studimi synon formimin e specialisteve të fushës së muzikës, artit skenik dhe arteve të bukura, të aftë për t'iu përgjigjur tregut të punës, duke i garantuar një nivel profesional të mirë, të besueshëm dhe kompetent.



2. Kurikula në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" zgjat jo më pak se një vit dhe në përfundim lëshohet diplomë "Master Profesional" me 60 ECT. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë Master Profesional është 1 (një) vit dhe për të fituar një diplomë Master Profesional, studenti duhet të ketë grumbulluar 60 kredite. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Studenti mund të përfundojë kursin e studimeve, të mbrojë punimin e diplomës brenda afateve të përcaktuara në përputhje me përcaktimet në rregulloren në fuqi të miratuar nga Senati Akademik, si dhe akteve Ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky cikël studimi synon në, formimin teorik dhe garanton një nivel dijesh më të lartë dhe më të profilizuar si nga ana teorike ashtu dhe praktike.
3. Kurikula në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave/Master i Arteve" zgjat jo më pak se dy vjet dhe në përfundim lëshohet diplomë "Master i Shkencave/Master i Arteve" me 120 ECT. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë Master i Shkencave/Master i Arteve është 2 (dy) vite dhe për të fituar një diplomë Master i Shkencave/Master i Arteve, studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite. Në këtë cikël përgatiten artistë të formuar me dije dhe shprehje të fushës në të cilën ato kanë diplomuar, në përshtatshmëri me tregun e punës dhe për kualifikime të mëtejshme nëse dëshirojnë të vazhdojnë studime të thelluara në Doktoratë.
4. Cikli i tretë i studimeve në Doktoratë është prioritet parësor i yni për vitet në vazhdim. Ky cikël studimi i thelluar do të ndihmojë të gjithë ato pedagogë dhe artistë të cilët kanë ambicie dhe dëshirojnë të vazhdojnë në fushën kërkimore dhe studiuere të artit dhe konkretisht:
 - Krijimin e një kontingjenti njerëzish të përzgjedhur, të përkushtuar që do të ishin një ndihmë e madhe dhe për vetë Universitetin e Arteve;
 - Krijimin e një mundësie në Universitetin e Arteve, dhe mbështetje e garantuar për të gjithë ato individë që nuk mund ta kryejnë këtë shkollim jashtë shtetit;
 - Krijimin e kushteve të nevojshme për tërheqjen në Universitetin e Arteve të artistëve të shquar si dhe kërkuesve dhe pedagogëve shqiptarë që punojnë në institucione të ngjashëm jashtë vendit.Si një përmbushje e standardeve Universitare të kërkuara edhe nga aktet ligjore në fuqi.

4.1. Mësimdhënia dhe studentët

Përsa i takon mësimdhënies dhe studentëve më poshtë janë renditur elementët thelbësorë që duhen analizuar:

- Programet mësimore dhe realizimi i tyre;
- Pozita dhe roli i stafit akademik;
- Pozita dhe roli i studentëve në procesin e edukimit;
- Organizimi i studimeve nga këndvështrimi i mësimin për gjatë gjithë jetës.

4.1.1. Programet mësimore dhe realizimi i tyre

Qëllimi

Qëllimi i Universitetit të Arteve është të sigurojë që të gjithë studentët të përfitojnë nga cilësia e lartë në mësimdhënie përmes plotësisht të nevojave të tyre, në përputhje me kërkesat e shoqërisë dhe tregut. Programet duhet të jenë të përshtatshme për t'iu përgjigjur përfituesve (tregut të punës).





Realizimi i programeve mësimore duhet të mbështetet në metodat që venë theksin tek studenti, si dhe që kërkojnë formimin e njohurive hap pas hapi. Këto lloj programesh duhet të marrin në konsideratë:

- Metodatat e mësimin të zhvillojnë motivimin dhe dëshirën tek studentët për mësimin dhe realizimet artistike duke e bërë sa më atraktive;
- Situata mësimi që lehtësojnë transferimin e njohurive teorike dhe modelojnë zgjidhje të problemeve, bazuar në shembujt individualë;

Rezultatet e pritshme

- Programe që lejojnë hyrjen në tregun e punës, zotërim të shpejtë të niveleve të mira të njohurive dhe aftësive konkurruese;
- Mësimdhënie që kërkon më shumë përfshirje të studentëve ;
- Mësimdhënie që i lejon studentëve njohjen në thellësi të materialit, zhvillimin e një mënyre vetë-konfidenciale dhe që minimizon studentët apatikë dhe jo aktivë;
- Nivel i mirë i njohurive dhe aftësive konceptuale, procedurale dhe transformuese, të bazuar në standardet akademike dhe sociale;
- Marrëdhënie kritike dhe krijuese tek studentët, për sa i takon përmbajtjes akademike, fenomeneve sociale, të përshtatshmërisë dhe tolerancës për zhvillimin e ideve të reja dhe të ndryshme.

Vështirësitë dhe pengesat

Vështirësitë që pengojnë realizimin dhe zhvillimin e programeve mësimore janë:

- Mbivlerësim i metodave tradicionale;
- Fonde të pamjaftueshme për aplikimin e teknologjive të reja në mësimdhënie;
- Fonde të pamjaftueshme për realizimin e projekteve artistike të lidhura me eksperimentimin;

Hapat strategjike

- Rritja e përfshirjes së mësimdhënies interaktive, bazuar në eksperiencën e punës me projekte;
- Përfshirja e stafit akademik, dhe e personaliteteve të artit në vend dhe ekspertëve të jashtëm në një dialog të vazhdueshëm, në drejtim të vlerësimit dhe zhvillimit të kurrikulave;
- Rishikimi i kurrikulave, në përputhje me njohuritë e reja dhe standardet e kërkuara të tregut të punës;
- Prezantimi i njohurive të reja në mësimdhënie;
- Materiale didaktike universitare si një obligim i pedagogëve;
- Përdorimi i rregullt i metodave të vlerësimit përmes një sistemi pikësh.

Veprimet

Për sa i takon mësimdhënies së avancuar duhet të kryhen këto veprime:

- Rritja e kohës së shpenzuar në mësimin dhe punën e pavarur dhe aktive, realizimet artistike, etj.
- Ndjekje e vazhduar e punës me studentët, bazuar në rezultatet e arritura në detyra, projekte artistike, etj., pa anashkaluar provimin përfundimtar



4.1.2. Pozita dhe roli i stafit akademik

Qëllimi

Punonjësit mësimor-shkencorë në Universitetin e Arteve janë burimi më i rëndësishëm për zhvillim dhe përparim. Për këtë qëllim, nevojitet një menaxhim modern dhe i përmirësuar në rritjen e cilësisë së personelit, duke stimuluar, vlerësuar dhe motivuar efektivitetin dhe arritjet në punë.

Në këtë drejtim, do të synohet në inkurajimin e punonjësve që vazhdimisht të zhvillojnë karrierën e tyre, si dhe në sigurimin e punësimit të përhershëm të personelit.

Roli i stafit akademik duhet të rritet në drejtim të një niveli të lartë kompetence në punën akademike, metodat e mësimdhënies si dhe në procesin edukativ. Pedagogu duhet të prezantohet si koordinator i aktiviteteve që inkurajojnë studentët të mendojnë për problemet, për zhvillimin e metodave krijuese, brenda disiplinave të tyre.

Po ashtu pedagogët duhet të jenë të hapur për dialog me studentët, duhet të mbështesin iniciativat e tyre dhe të jenë të përgatitur për debat në lidhje me çështjet e programit mësimor.

Profesionalizimi dhe përsosja e mësimdhënies

Përmirësimi i mësimdhënies nuk mund të kryhet pa ndërmarrjen e hapave të rëndësishme në drejtim të përvetësimit aktiv e logjik të njohurive, në ngritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies e krijimtarisë si dhe në mënjanimin e të mësuarit mekanik dhe pasiv.

Rezultatet e pritshme

Stafi akademik për realizimin e synimeve të mësipërme duhet të përgatitet në drejtimet e mëposhtme:

- Të harmonizojë pjesëmarrjen në mësim dhe kërkim me realizimet artistike;
- Të ndërtojë marrëdhënie të drejta me studentët, duke rritur respektin dhe besimin e studentëve;
- Të nxisë dhe promovojë profesionin në shoqëri dhe të jetë i gatshëm për dialog dhe shkëmbim njohurish midis komunitetit akademik dhe jo akademik.

Vështirësitë dhe pengesat

Vështirësitë janë:

- Mungesa e teknologjisë bashkëkohore për një shpërfaqje më të mirë të praktikës me teorinë;
- Mungesa e trajnimeve në vazhdimësi;

Hapat strategjikë

Hapat strategjikë që inkurajojnë rritjen e efektivitetit të pedagogëve janë:

- Realizimi i kushteve të përshtatshme e dinjitoze, disponibiliteti i teknologjive moderne, materialeve mësimore dhe laboratorike dhe literaturës;
- Promovimi i vazhdueshëm në fushën e mësimi;
- Kalimi në organizimin e mësimi me bazë studioje, atelie etj. Në këtë mënyrë do të kemi një titullar udhëheqës dhe asistentët të cilët do drejtojnë gjithë aspektet ushtrimore, didaktike e praktikën e grupeve apo individëve studentë;



- Zgjerimi i shkëmbimit të eksperiencës dhe kooperimit të pedagogëve në fusha dhe institucione të ngjashme jashtë vendit.
- Krijimi i lidhjes së brezave të mësimdhënies për program studimi për të krijuar vazhdimësinë e eksperiencave nga brezi në brez.

Veprimet

Veprimet që kanë si synim rritjen e efektivitetit në mësimdhënie janë:

- Përmirësimet e nevojshme ligjore;
- Aplikimi i hapave në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të punës mësimore e krijuese;
- Fillimi i procesit për racionalizimin e Fakulteteve dhe të Departamenteve dhe për sigurimin e barazisë dhe aksesit;
- Nxitja e iniciativave të pedagogëve për investime nga të ardhura me projekte e grante të ndryshme (për zyrat, hapësirat e krijimtarisë dhe të studimit etj), në ndihmë të Universitetit të Arteve;
- Inkurajimi i kooperimit ndërkombëtar dhe shkëmbimi i pedagogëve.

4.1.3. Pozita dhe roli i studentëve në procesin e edukimit

Qëllimi

Studenti është pjesa kryesore dhe si i tillë është i përfaqësuar në Senatin Akademik të UA. Marrëdhëniet bazë midis studentëve dhe stafit akademik duhet të jenë marrëdhënie partneriteti dhe njohjeje reciproke. Partneriteti do të lejonte studentët të bëheshin aktivë në procesin e edukimit dhe krijimtarisë:

- Respektimin e nevojave, interesave dhe të drejtave të studentëve;
- Aspektin demokratik të marrëdhënieve përmes komunikimit të ndërsjellë;
- Garantimin se diplomimi i tyre është në përgjigje të kërkesave kryesore për jetën, punën dhe të ardhmen;
- Inkurajimin dhe zhvillimin e vlerave civile dhe mundësive të tjera.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet e këtij partneriteti do të ishin:

- Vetëbesimi i studentëve në përgjegjësitë e potencialin e tyre;
- Mundësitë për të plotësuar interesa të ndryshme të studentëve, përmes formave të ndryshme të përfshirjes;
- Gatishmëria e studentëve, për të marrë përgjegjësi për mësimin, krijimtarinë dhe edukimin;
- Gatishmëria e studentëve për të vazhduar bashkëpunimin me Universitetin e Arteve edhe pas diplomimit;
- Motivimi i studentëve për kooperim me stafin mësimor e shkencor, për projekte të ndryshme.

Vështirësitë dhe pengesat

Vështirësitë në realizimin e marrëdhënieve të tilla janë:

- Përfshirja e tyre në vendim marrje;



- Pasiviteti si rezultat i eksperiencave jo të mira paraprake të edukimit;

Hapat strategjikë

Hapat strategjikë në realizimin e marrëdhënieve midis partnereve do të ishin:

- Shqyrtimi në mënyrë sistematike dhe ndjekja e nevojave të studentëve;
- Realizimi i kushteve më të mira për studentët për jetesë në kuadrin e komunitetit universitar;
- Ndryshimi i cilësisë së komunikimit me studentët, duke ndryshuar sjelljen dhe mentalitetin në procesin metodik e krijues;
- Vendosja e mekanizmave mbrojtës, në lidhje me marrëdhëniet e vështira;
- Përfshirja e studentëve në procesin e planifikimit të mësimit dhe marrja në konsideratë e opinionëve të tyre në nivele të ndryshme të vendimmarrjes.

Veprimet

Veprimet për realizimin e marrëdhënieve të partneritetit janë:

- Zgjidhja e përbashkët e problemeve për të siguruar standarde më të mira të studentëve duke kërkuar ndihmën e qeverisë dhe komunitetit artistik ashtu si dhe institucioneve qendrore dhe lokale artistike.
- Realizimi i standardeve në lidhje me hapësirat e mësimit në fakultete;
- Rregullimi i mjediseve të studentëve mundësisht në përputhje me kërkesat specifike të tyre;
- Krijimi i laboratorëve artistikë në studio, atelie e salla, duke përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme për to si dhe bazën materiale;
- Sigurimi i burimeve specifike për inkurajimin e projekteve individuale të lidhura me fushat artistike;

4.1.4. Organizimi i studimeve nga këndvështrimi i mësimit për gjatë gjithë jetës

Qëllimet e zhvillimit:

Në Universitetin e Arteve një rëndësi e veçantë do të duhet t'ju kushtohet programeve afatshkurtër me specializim specifik, të formuluar në përputhje me kërkesat që paraqet tregu i punës apo të programeve që kanë si qëllim "rifreskimin periodik të njohurive".

Rezultatet e pritshme

Rezultatet që priten nga kjo janë:

- Eficiencë që lidhet me ndryshimin e shpejtë të kushteve të punës në disa fusha të aktivitetit;
- Arsimitimi në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Përgjigje e shpejtë e ndryshimeve në nivel lokal dhe global;
- Ofrimi i mundësive shtesë të arsimimit; etj.

Vështirësitë dhe pengesat:

- Mosnjohja e rolit të Universitetit të Arteve në procesin e mësimit gjatë gjithë jetës;
- Mungesa e njohurive për sa i takon nevojave të individëve.



Hapat strategjike në drejtim të organizimit të studimeve nga pikëpamja e mësimit gjatë gjithë jetës duhet të përfshijnë:

- Ndjekjen në mënyre të vazhdueshme të nevojave për mënyrat e edukimit gjatë gjithë jetës;
- Vendosijen e marrëdhënieve me shkollat e artit dhe institucionet artistike me qëllim që të përpunohen modelet e diplomimit dhe licencimit të profesioneve;
- Krijimin e mundësive për kombinimin ndërdisiplinor të programeve të bazuara në nevojat e përdoruesve.

Veprimet

- Përcaktimi i nevojave dhe i mekanizmave për lidhjen e tyre me të interesuarit që kërkojnë programe specializimi;
- Përfshirja e studimeve të formimit të ngushtë profesional në programet e nivelit të dytë;
- Kërkimi dhe përfshirja e modeleve të organizimit të studimeve duke u mbështetur edhe në modelet e shkollave të ngjashme në Evropë;
- Inkurajimi dhe zhvillimi i programeve ndërdisiplinore në nivelet universitare (Bachelor, Master dhe Doktoratë).
- Inkurajimi i programeve të formimit të vazhduar të "freskimit profesional" dhe programeve specifike të specializimit;

4.1.5. Afatet kohore

- Në vitet akademike 2018 - 2020 shpresojmë të arrihen hapjet e programeve të studimit në ciklin e tretë në Doktoratë në UA si dhe të disa programeve të reja në Bachelor dhe Master.

5. SIGURIMI I CILËSISË

Sigurimi i cilësisë mbetet kërkesë themelore e Universitetit të Arteve për rritjen e reputacionit brenda e jashtë vendit.

5.1. Rritja e cilësisë

- Presioni i konkurrencës si dhe diversiteti i nevojave, bën të domosdoshme që Universiteti i Arteve të rrisë fleksibilitetin për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës. Për këtë parashikohet të ketë diversitet modelesh, metodash etj. Për këtë duhet promovuar mësimi e krijimtaria përmes angazhimit në punë praktike konkrete që të mund të arrihet zhvillimi i vazhdueshëm profesional.
- Pedagogët duhet të tregojnë profesionalizëm në disiplinat e tyre. Zhvillimi i tyre profesional është me rëndësi në drejtim të arritjes së objektivave strategjike.
- Cilësia e të mësuarit lidhet edhe me kombinimin e aftësive dhe eksperiencave në radhët e stafit akademik. Është e nevojshme që të rritet vlerësimi dhe shpërblimi për stafin e dalluar.

5.2. Sistemi i sigurimit të cilësisë

Sigurimi i cilësisë në Universitetin e Arteve mbulon të gjitha aktivitetet që përfshijnë vlerësimin, mbikëqyrjen dhe akreditimin, të tilla si:

- Autorizimin që lejon institucionin të ushtrorë aktivitetet didaktik, në Arsimin e Lartë.



- Adaptimi dhe miratimi i kurrikulës;
- Vlerësimi i institucionit (organizimi dhe menaxhimi, mësimi dhe kërkimi dhe krijimtaria)
- Adaptimi dhe zbatimi i kriterëve për rekrutimin e pedagogëve;
- Vlerësimi i pedagogëve dhe studentëve.

5.3. Synimet e zhvillimit

Në aplikimin dhe zhvillimin e një sistemi të gjerë e me dobishmëri të sigurimit të cilësisë, duhet të përfshihen të gjithë aktorët: shteti, pedagogët studentët dhe strukturat ndihmëse.

Synimi i zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Arteve përfshin hartimin e politikave, procedurave, kulturës për sigurimin e cilësisë, duke e krahasuar me standardet e vendosura.

Synim i veçantë në sigurimin e cilësisë në Universitetin e Arteve është sistemi i vetëvlerësimit, mbikëqyrjes dhe akreditimit, duke respektuar autonominë.

Sistemi i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimi periodik fokusohen në:

- Organizimin dhe menaxhimin;
- Financimin e përshtatshëm;
- Politikat e qëndrueshme për rekrutimin e stafit;
- Procesin e mësimi; rritjen e mobiliteteve të pedagogëve dhe studentëve;
- Prezantimin dhe zbatimin e ECTS, skemën e akreditimit, zhvillimit të kurrikulës, metodat e reja të mësimarrjes dhe tutorimit, etj.
- Procesin e kërkimit dhe realizimeve artistike në Universitetin e Arteve.

5.4. Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme, ndër të tjera janë:

- Përcaktimi i kriterëve dhe treguesve të cilësisë institucionale në lidhje me programet, mësimin, krijimtarinë e kërkimin shkencor, problematikën e studentëve, etj.
- Vendosja e rregullave, kriterëve në se mekanizmat e sigurimit të cilësisë e kërkojnë, me qëllim që të përmirësohet cilësia në institucion në lidhje me: organizimin dhe financimin e tij, vlerësimin e kurrikulës, kriteret dhe standardet për promovimin e studentëve, vlerësimin e pedagogëve dhe studentëve, etj;
- Rritja e shpirtit konkurrues në shkollë në marrëdhëniet brenda dhe jashtë vendit;
- Përfshirja më e madhe e Universitetit të Arteve në projekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit;
- Rritja e aftësive tek pedagogët dhe studentët, në përputhje me kërkesat e shoqërisë dhe të tregut.
- Rritja e mobiliteteve të pedagogëve dhe studentëve;
- Rritja e numrit të projekteve të përbashkëta me shkolla të ngjashme evropiane;
- Mundësi më të mira të punësimit të studentëve;
- Përdorim masiv i teknologjisë së informacionit.



5.5. Hapat strategjikë

Sistemi i sigurimit të cilësisë merr në konsideratë kontrollin që ndjek veprimtarinë e akademisë përmes vlerësimit të brendshëm. Konsiderata të veçanta i duhen kushtuar zhvillimit të modeleve të vlerësimit gjatë zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë.

Ky aktivitet përfshin, ndër të tjera:

- Vetë analizën,
- Treguesit e cilësisë,
- Vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve,
- Vlerësimin e studentëve,
- Vlerësimin e programeve mësimore,
- Vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore e krijuese,
- Vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve nacionale, rajonale dhe më gjerë,
- Pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve të komunitetit artistik;

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar gjithashtu dhe interpretimit të vlerësimit dhe zhvillimit të veprimeve të përbashkëta, në rast të konstatimeve si negative ashtu dhe pozitive.

Hapat strategjikë në sistemin e zhvillimit të cilësisë janë si më poshtë:

- Përcaktimi i rolit dhe detyrave në sistemin e sigurimit të cilësisë në nivele të ndryshme (universitet, fakultet, departament);
- Ndryshimi i strukturës organizative gjatë menaxhimit të cilësisë, gjë që do të thotë shpërndarje e përgjegjësisë dhe aktiviteteve në nivelet përkatëse;
- Vendosja e politikave të qëndrueshme të regjistrimit;
- Zhvillimi dhe perfeksionimi i një modeli të brendshëm të vlerësimit institucional.

5.6. Veprimet

Veprimet që do të ndërmerren për të vendosur sistemin e sigurimit të cilësisë janë si më poshtë:

- Përfshirja vazhdimisht e stafit akademik në veprimtaritë që lidhen me analizën e sistemit ekzistues dhe thithja e eksperiencës kombëtare dhe ndërkombëtare përmes workshopeve;
- Organizimi i takimeve ku pjesëmarrësit të diskutojnë standardet, sigurimin e cilësisë, procedurat e vlerësimit dhe interpretimin e rezultateve të vlerësimit;
- Politikat e pranimit në programet e studimit në Universitetin e Arteve;
- Informimi i vazhdueshëm rreth rregullave të vlerësimit, ku të gjithë personat e përfshirë në vlerësim duhet të informohen në kohën e duhur;
- Vlerësimi i cilësisë së institucionit, kurrikulës, procesit mësimor, pedagogëve, studentëve, duhet të kontrollohet në mënyrë periodike dhe më pas duke marrë masat e nevojshme për përmirësim.

6. PROJEKTET ARTISTIKE DHE KËRKIMI SHKENCOR

6.1. Objektivi kryesor

Si objekt kryesor në planin Strategjik të 2018-2020, përkrah projekteve artistike të cilat kanë qenë gjithmonë pjesë kryesore e punës është hapja e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë.





6.2 Objektivat specifike

- Hapja e studimeve doktorale.
- Mbështetja e projekteve artistike dhe e një sistemi kërkimor me kapacitetin për t'ju përgjigjur ndryshimeve kohore.
- Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të projekteve.

6.3. Situatat ekzistuese

Projektet artistike në disa raste janë të bazuara në projekte individuale, jashtë veprimtarive universitare.

Financimet e projekteve artistike ashtu si dhe kërkimit në përgjithësi janë të pamjaftueshme ose mungojnë plotësisht duke bërë që ato të jenë shumë të limituara.

Gjendja e mjeteve kërkimore dhe laboratorëve janë të niveleve jo të kënaqshme.

Zhvillimi i profesioneve dhe kontributi i UA në këtë zhvillim është i kufizuar për arsye objektive.

6.4 Qëllimet e përgjithshme

- Fuqizimi i punës me projektet artistike dhe shkencore në kontekst, cilësi, qëllim.
- Ndërtimi sistematik dhe promovimi, për identifikimin akademik dhe vlerësimit të aktivitetit artistike-shkencore universitare.
- Forcimi i kooperimit të Universitetit të Arteve me institucionet publike artistike dhe kërkimore-shkencore.
- Sigurimi i kushteve për aktivitet artistik dhe shkencor për stafin akademik
- Mbështetja institucionale e projekteve me ndikim të gjerë dhe me zbatim direkt të dijeve.

Autonomia e vendimmarrjes në seleksionimin dhe promovimin e projekteve artistike, vë në lëvizje konkurrencën artistike, shkencore e profesionale në mënyrë që Universiteti i Arteve të realizojë misionin që ka përballë shoqërisë.

Universiteti i Arteve do të përshpejtojë realizimin e projekteve artistike, shkencore dhe profesionale duke marrë masa administrative.

Universiteti i Arteve mund t'i kërkojë shtetit të eliminojë taksat doganore dhe taksat e tjera të artikujve shkencorë dhe profesionalë me përdorim të gjerë dhe elementëve bazë si, instrumente, software etj.

Për të mbështetur drejtimit e punës shkencore duhet të merren disa masa organizative, që lidhen me shtimin e numrit të punonjësve shkencorë, me përmirësimin e strukturave organizative etj.

- Në të gjitha njësitë e Universitetit të Arteve të forcohen grupet e profilizuara që mbulojnë drejtime të ngushta studimesh. Me kohë, mbi bazën e tyre të ngrihen sektorë apo njësi të reja shkencore;
- Më mirë duhet të praktikohet ardhja e specialisteve të huaj për ngritjen e aktiviteteve të reja, për mbajtje ligjëratash dhe shkëmbim përvoja apo dërgimet e pedagogëve tanë jashtë shtetit me afate të shkurtra për probleme të caktuara.

7. FINANCIMI

Duke qenë se çështjet financiare vazhdojnë të jenë një nga elementet kyç të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë publik, çdo ndërhyrje apo ndryshim në këtë aspekt duhet të jetë i menduar mirë, me qëllim që jo vetëm të mos cenohet ecurinë normale të IAL-ve, por edhe ta nxisë e të rrisë cilësisht atë.



Strategjia mbi reformën financiare është e nevojshme t'i referohet një numri faktorësh që ndikojnë në vetë ekzistencën e institucioneve të arsimit të lartë, qoftë publik apo edhe privatë, duke tentuar drejt krijimit të modeleve referuese, të cilat do të mund të përcaktonin kriteret lidhur me financimin publik apo skemat e mundshme të këtij financimi. Performanca e institucioneve të arsimit të lartë padyshim që përbën një koncept për t'u mbështetur në këtë reformë.

Sigurisht modelet do të duhej të krijonin hapësira për individualitete, në rastet kur këto individualitete kanë të bëjnë ngushtësisht me vetë qëllimin dhe funksionimin e një IAL -je. Këto individualitete do të mund të përfshiheshin në skemën e financimit qoftë edhe si raste përjashtimore apo raste me prioritet të veçantë.

7.1. Referenca për Universitetin e Arteve

Universiteti i Arteve nga pikëpamja e organizimit të procesit mësimor didaktik e krijues ndryshon nga Universitetet e tjera për vetë specifikat që ka një shkollë arti.

Universiteti i Arteve çdo vit përkundrejt kërkesave të tij pranon një numër të kufizuar studentësh dhe kjo për disa arsye:

- **Së pari** një shkollë arti nuk mund të hapet për të gjithë por vetëm për të talentuarit.
- **Së dyti** tregu i punës në fushën e artit në vendin tonë nuk mund të përthithë një numër më të madh studentësh.

Ky numër i vogël i studentëve ndikon drejtpërsëdrejti në një moment shumë të rëndësishëm të funksionimit përse i përket realizimit të të ardhurave nga tarifa e studimit. Ne pranojmë çdo vit rreth 200 studentë në ciklin e parë dhe rreth 120 në ciklin e dytë. Nga këto shifra mund të kuptojmë më së miri masën e realizimit të të ardhurave.

Në themel të pranimin të studentëve në Universitetin e Arteve qëndron cilësia në një fushë të caktuar krijuese e artistike. Pra, në parim të pranimin të studentëve ne kemi cilësinë artistike të njohur si të tillë nga një komision artistik. Kjo të çon kategorikisht në një numër të reduktuar të studenteve në këtë institucion.

Një moment tjetër i rëndësishëm dhe që ndikon drejtpërsëdrejti në financimin e shkollës është mënyra e organizimit të procesit metodik. Në shkollën tonë të artit ashtu si në çdo shkollë tjetër të artit në botë mësimi organizohet në masën më të madhe në orë individuale dhe një përqindje shumë e pakët në orë kolektive. Kjo ka kosto të madhe po të llogarisim numrin e madh të orëve të mësimin që dalin si rezultat i këtij procesi. Po ashtu për vetë specifikën kemi organizime të punës në grupe të vogla studentësh, me një numër prej 3-4 të tillë si muzika e dhomës, kuartete të ndryshme, fragmente apo pjese teatrore që kërkojnë grupe të vogla studentësh.

Po ashtu një moment tjetër ka të bëjë me mjetet profesionale në mbështetje të procesit akademik të domosdoshme për karakterin e UA. Studentëve duhet tu sigurojë UA pajisjet e nevojshme siç është piano, kontrabasi apo dhe instrumente të tjera të cilët janë të domosdoshme për procesin. Po e njëjta gjë mund të thuhet për regjinë e filmit apo skulpturën ku ne si shkollë duhet të sigurojmë kamera, pika montazhi, sisteme ndriçimi, furrë për qeramikë, baltë speciale, mermerë apo gurë masive etj. Sigurimi i pajisjeve dhe i materialeve është pothuajse në të gjitha programet e studimit që ofron UA dhe përballohen nga vetë universiteti dhe kërkon fond të madh për investime. Ky fond nevojitet jo vetëm për blerjen por edhe për mirëmbajtjen periodike të tyre.

Duhet mbajtur parasysh niveli maksimal i tarifës së shkollimit të UA, e cila duhet të bëjë një diferencë nga IAL-të e tjera publike në Shqipëri.





Gjithashtu një ndikim jo të vogël kanë edhe përjashtimet nga tarifat e shkollimit.

Të gjitha sa u renditen me sipër flasin për specifikën e UA dhe për nevojën e një ndjeshmërie të veçantë në drejtim të financimit të kësaj shkolle arti. Kjo jo për të kërkuar një trajtim më të favorshëm se IAL-të e tjera, por për të ngritur argumente mbështetëse në lidhje me nevojën e përcaktimit të kritereve të drejta dhe proporcionale për financimin e IAL-ve.

Kritere të mundshme mund të jenë:

-Veçantia e programeve të studimit,

Ky kriter merr parasysh unikalitetin e programeve të studimit në një shkollë arti dhe ka në bazë të tij ruajtjen e një tradite shumëvjeçare. Ky kriter krijon mundësinë edhe të një përqsajeve strategjike lidhur me fusha të rëndësisë së veçantë që përcaktohen si prioritete

Kosto e studimeve (mesatarisht kosto mesatare për student 350000 lekë).

Ky kriter merr parasysh koston e përlllogaritur të studimit për çdo student, duke vlerësuar nevojat konkrete për zhvillimin e procesit mësimor, mbi bazën e një analize të hollësishme të zërave buxhetorë. Minimalisht ky kriter duhet të merret në konsideratë për ato shkolla që kanë një numër studentësh më të vogël se 2000 studentë

Numri i personelit akademik

Ky kriter merr parasysh numrin e personelit akademik të përhershëm, angazhuar në një IAL, në raport me numrin e studentëve. Po ashtu duhet të merret parasysh edhe numri i personelit akademik të ftuar dhe pesha specifike që zë pagesa e tyre në të ardhurat e veta të një IAL-je.

7.2. MENYRA E FINANCIMIT

Për sa i takon mënyrës së financimit është mjaft e rëndësishme që financimi të jetë një proces i konsoliduar, me tendencë rritëse nisur nga specifika e Universitetit të Arteve. Kjo siguron nga njëra anë qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe nga ana tjetër konsolidimin e programeve të studimit.

Financimi duhet të vijë jo vetëm nga një burim i mirë përcaktuar. Ne mendojmë se përballimi i plotë i buxhetit, e konkretisht nga Ministria që mbulon arsimin e lartë i shpenzimeve të procesit akademik mësimdhënës është një domosdoshmëri. Në këtë rast mund të përfshihen më së paku nevojat për financim të shpenzimeve të:

- Personelit akademik,
- Bazës materiale didaktike, mësimore (mjetet e punës që lidhen direkt me mundësinë e të zhvilluarit të procesit mësimor dhe të përmbushjes së veprimtarive të ndryshme që ky proces përfshin),
- Mirëmbajtje të aktiveve të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe vijueshmërinë e procesit mësimor,
- Administrative, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor,
- Nga përjashtimi i shtresave të ndryshme.

Ndërkohë, në referim të investimeve që mund të ketë nevojë apo planifikon UA, burimet dhe format e financimit mund të jenë të ndryshme. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet granteve konkurruese, duke bërë të mundur edhe nxitjen e UA për zhvillim të kapaciteteve, por pasi të jetë siguruar ecuria e procesit akademik mësimor brenda standardeve të kërkuara.

Ndërsa mbështetjen financiare të projekteve krijuese si dhe menaxhimin e tyre do ta shikojmë si zgjidhje me projekte të aplikuara për konkurrim dhe të mbështetura nga Ministria e Kulturës



Investime PBA 2018 - 2020

Nr	Emertimi I investimit	Viti 2018 (lek)	Viti 2019 (lek)	Viti 2020 (lek)
1	Analiza e studimit dhe detyra e projektimit per UART	418,841		
2	Projekt - Ide paraprake per UART	5,092,756		
3	Projekt - Ide perfundimtare per UART		6,170,000	
4	Projekti per miratimin e Lejes se Ndertimit per UART		3,891,179	
5	Studimi Urbanistik per UART		474,040	
6	Oponence teknike per projektin e rikonst. te ndert. te Korpusit Kryesor	673,468		
7	Pregatitje procedure tenderimi te rikonst. te ndert. te Korpusit Kryesor	421,971		
8	Rikonstruksionin i nderteses te Korpusit Kryesor	68,511,085	94,952,571	
9	Rikonstruksionin i nderteses te Korpusit Kryesor		13,439,014	
10	Mbikqyrja e punimeve e rikonstruksionit te ndert. te Korpusit Kryesor		3,270,277	
11	Kontabilizimi i rikonstruksionit i nderteses te Korpusit Kryesor			316,478
12	Projekt per rikonstruksionin e Salles se Madhe te Koncerteve		3,666,784	
13	Projekt per rikonstruksionin e Nderteses F		1,018,551	
14	Projekt per rikualikimin funksional dhe arkitektonik te Bibliotekes	872,352		
15	Projekte per ndertime te reja			17,086,196
16	Pajisje audiovizuale	46,507,119	1,083,000	
17	Elektroshtepiake	2,382,000		
18	Fotokopje	600,000		
19	Kompjuter etj	15,646,651	15,958,000	
20	Sisteme kondicionimi	2,248,000		
21	Libra	168,434		
22	Mobilim	5,430,080		
23	Ndertesa (mirembajtje)	4,152,320		
24	Pajisje teknike etj	10,396,131		
25	Printer, skaner	3,870,880	206,000	
26	Programe kompjuterike	674,000	1,200,000	
27	Projektor	3,939,800	1,950,000	
	TOTALI	172,005,889	147,279,416	17,402,674

